

Berat, më 04.04.2017

DREJTUAR: AKM - TIRANË
PER DIJENI: DRM – BERAT
KOMUNA BOGOVE, QARKU BERAT

**LENDA: KERKESE PER PJESEMARRJE NE
ORGANIZIMIN E KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE
PALET E INTERESUARA PER APLIKIMIN PER LEJE
MJEDISI TE TIPIT B: ID 3.7 NXJERRJA E
MINERALEVE, RËRËS DHE ARGJILËS NGA
MINIERAT ME SHFRYTËZIM NË QIELL TË HAPUR
(SHFRYTEZIM KARRIERE GURIT GELQEROR
PLLAKOR)**

SUBJEKTI : "ALION" SH.P.K.

ADMINISTRATORI: Z. HAXHI KREKU

**VENDNDODHJA: OBJEKTI NDODHET NE AFERSI TE FSHATIT NOVAJ,
KOMUNA BOGOVE, SKRAPAR, QARKU BERAT**

Subjekti “ALION” Sh.P.K. me perfaqesues ligjor Z. HAXHI KREKU merret me Aktivitetin ID 3.7 Nxjerrja e Mineraleve, Rërës dhe Argjilës nga Minierat me shfrytëzim në qiell të hapur (Shfrytëzim karriere Gurit Gelqeror Pllakor).

SUBJEKTI : SUBJEKTI “ALION” SH.P.K. ME NR. NIPTI K32803014D

ADMINISTRATORI: Z. HAXHI KREKU

**OBJEKTI NDODHET AFER FSHATIT NOVAJ, KOMUNA BOGOVE,
RRETHI SKRAPAR, QARKU BERAT**

Shoqeria “ALION” Sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin teknik dhe ligjor per Leje Mjedisi te Tipit B per Karriere per shfrytëzimin e Gurit Gelqeror Pllakor, pa perdorimin e lendeve plasese.

Objekti ndodhet ne distanca te largeta mbi 5km nga qendrat e banuara, duhet theksuar se objekti eshte kullote i zhveshur, dhe nuk ka pamje nga rruga, si dhe aktiviteti ka bere të mundur zbutjen e papunesise ne kete zone, duke bere punesuar nje pjese te mire te banoreve te kesaj zone.

- Kapaciteti prodhues vjetor i karrieres eshte 20.000 m³ / vit.
- Sipërfaqja e karrieres eshte 0.16 km²

Subjekti “ALION” Sh.p.k ka marrë të gjitha masat e duhura për zbutjen e ndikimeve dhe mbrojtjen e mjedisit në tërësi.

Nisur edhe nga qellimi i kesaj veprimtarise shqyrtimi i alternativave eshte i veshtire sepse flitet per objekte minerare me cilesi minerali unike te cilat plotesojne kriteret e kerkuara nga tregu perkates. Kuptohet qarte qe kemi te bejme me nje investim te madh nga investitori i cili se pari analizon koston dhe perfitimin

1. Objekti permban rezerva mineral te mjaftueshme te shfrytëzueshme.
2. Kerkon investime te pranueshme per venien nen shfrytëzim.

3. Paraqet mundesi aksesit rrugore ne objekt dhe faktoret klimatike te zones favrizojne veprimtarine
4. Ne zone egziston krahu i punes etj
5. Nuk cenon vlera cilesore apo te vecanta mjedisore dhe sociale
6. Eshte miratuar nga Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjitikes dhe institucionet lokale te shtetit dhe komuniteti i zones.

Procesi i prodhimit dhe karakteristikat e tij

Procesi i prodhimit pra shfrytezimit dhe terheqjes se mineralit do te behet ne qiell te hapur me karriere dhe pa perdorimin e lendeve plasese.

Menyra e shfrytezimit te mineralit me karriere ne qiell te hapur

Shfrytezimi i vendburimit do te behet me karriere ne qiell te hapur dhe me shkalle.

Shfrytezimi do te filloje ne kuoten poshtme prej +250 deri ne ate te sipërme prej +300.

Kohezgjatje e shfrytezimit parashikohet 10 vjet me rezerva prej 259.302 m³.

Karriera shfrytezohet rreth 260 dite ne vit dhe paralel me hapjen e karrieres jane bere edhe sistemimet perkatese te profileve te shfrytezuara.

Per te realizuar shfrytezimin ketu realizohet me ekstravator dhe eskavator me cekic pneumatic dhe transporti behet me kamione.

Operacionet kryesore gjate fazes se prodhimit jane:

- Rrezimi i masave me cekic pneumatic ose sonde copetim mekanik
- Punime sistemimi te perkohshem
- Ngarkimi ne kamione dhe transporti

Per nga natyra e proceseve te prodhimit mund te thuhet se jane procese te natyres fiziko – mekanike dhe nuk do te kete procese te mirefillta kimike dhe perdorimi i agjenteve te vecante kimike ne procesin e prodhimit.

Teknologjite dhe makinerite e projektit

Ne procesin e zbulim – prodhimit punohet me keto makineri dhe teknologji:

- Ekskavatore
- Cekic pneumatic
- Kamione transporti

Energjia qe perdor teknologjia eshte e lendes djegese fosile dhe perkatesisht naftes diesel 10pm.

Ne afersi te zones ku zhvillon aktivitetin subjekti nuk ka shkolla ,vepra arti,argjinatura,linje eletrike dhe linje uji qe mund te demtohen nga zhvillimi i aktivitetit.

Pervec interesit ekonomik , investitori ka bere rregullime ,sistemime te sheshit para objektit, rrugeve, ka krijuar hapsira te gjelberta.

Aktiviteti zhvillohet ka kohë që ekziston dhe nuk ka patur asnje problem me komunitetin dhe nuk ka shkaktuar probleme të ndotjes së mjedisit.

Me këtë raport sigurojmë organet përkatëse shtetërore, vendim – marrëse, se projekti i zbatimit dhe teknologjia e projektuar është bashkëkohore, cilësore dhe plotëson standartet e vendosura nga Bashkimi Evropian.

Aktiviteti jone ka bere të mundur zbutjen e papunesise ne kete zone, duke bere punesuar nje pjese te mire te banoreve te kesaj zone.

Nga pikpamja sociale, zhvillimi i ketij aktiviteti eshte faktor per zbutjen e papunesise dhe burim te ardhurash per familjet qe jetojne duke punuar ne kete shoqeri.

Pershkrimi i vendburimit

Objekti eshte prone shteterore dhe ndodhet prane Fshatit Novaj, Komuna Bogovë, Rrethi Skrapar, Qarku Berat. Objekti ndodhet ne distanca te largeta nga qendrat e banuara, mbi 5 km, duhet theksuar se objekti eshte kullote i zhveshur, dhe nuk ka pamje nga rruga, si dhe aktiviteti ka bere të mundur zbutjen e papunesise ne kete zone, duke bere punesuar nje pjese te mire te banoreve te kesaj zone.

Kjo zone eshte e degraduar, nuk ka bimesi por ne vende te rralla shkurre te pazhvilluara dhe barishte te ndryshme.

Nuk gezon ndonje status te vecante mbrojtjeje per sa i perket flores, faunes dhe habitateve te ndryshme .

Bimesia e rralle e saj nuk favorizon jetesen e kafsheve dhe shpendeve te ndryshme te egra

Ne kufijte zones se shfrytezimit dhe jashte saj nuk ka livadhe, kullota dhe siperfaqe te mbjella te cilat mund te preken dhe demtohen nga aktiviteti i shfrytezimit ne te.

Pejsazhi karakteristik i zakonshem i zones nuk do te ndikohet nga ushtrimi i aktivitetit te shfrytezimit, mbasi zona e shfrytezuar nuk duket nga rruga ajo do te zhvillohet ne brendesi te kodres.

Bimesia dhe pemet e zhvilluara ne menyre natyrale ne siperfaqen qe do t' i nenshtrohet shfrytezimit perfaqsohet nga shkure te zakonshme te cilat nuk gezojne ndonje status te vecante mbrojtjeje .

Bimet dhe pemet me karakteristike te kesaj zone jane ne kete objekt nuk ekzistojne pasi kjo zone I eshte nenshtruar shfrytezimit te gurit dekorativ per disa vite rradhaz:

Ushtrimi i aktivitetit te shfrytezimit nuk ju heq banoreve te zones, te drejten per perdorim shtepiak privat dhe tradicional te perberesave te biodiversitetit .

Zona, ne te cilen do te zhvillohet aktiviteti i shfrytezimit te karieres, eshte pothuajse teresisht e zhveshur. Rigjenerimi i saj pas shfrytezimit me ane te perpunimit, trajtimit, sistemimit dhe mbjelljes se siperfaqes me perberesa tradicionale e zonale te biodiversitetit do te rrite me shume mundesine e perdorimit te tyre nga banoret e zones per rreth .

Vendi i zhvillimit të aktivitetit të shfrytëzimit dhe projekti i shfrytëzimit janë zgjedhur në mënyrë të tillë, që duke shfrytëzuar sipërfaqen e zgjedhur, proceset e ndryshme që do të zhvillohen gjatë këtij aktiviteti të mos jenë të ekspozuara.

Sipërfaqja në të cilën do të shtrihet shfrytëzimi i objektit nuk duket nga banoret e qyteteve, fshatrave apo qendrave të tjera të banuara, me përjashtim të rasteve për kalimtarët që udhetojnë me këmbë në zonën në afërsi të objektit. Aktiviteti prodhues i karrierës zhvillohet në sipërfaqe dhe depozitimi i gureve gelqeror pllakor dekorativ bëhet në zonën e përcaktuar në projekt. Gjatë dhe pas shfrytëzimit të këtij objekti nuk parashikohet të ketë tipare të tjera mjedisore të tjetërsuar nga ato karakteristike të zonës.

Aktiviteti prodhues ushtrohet në zonën e cila nuk përfshihet në zonat e mbrojtura me ligj si: rezervat kombëtare natyrore, zona me interes shkencor të veçantë, parqet kombëtare, zonat me bukuri të rrallë natyrore, brigjet e trashëguara, parqet rajonale dhe rurale, parqet pyjore kombëtare, rezervat lokale natyrore, zonat ujore të mbrojtura, zonat e ndjeshme, zonat e mbrojtura, ndërtimet me vlera, monumentet e lashtësisë, si dhe zonat me rëndësi arkeologjike.

Ndikimet në mjedis

Ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në ndryshimin e nivelit të ujërave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujërave nëntokësore, pasi në këtë zonë ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta.
- Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë shkarkime të lëndëve ndotëse në ujë.

- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave pasi do punohet vetem ne karriere.
- Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë emetime të ndryshme kimike të llojeve të ndryshme.
- Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth.
Niveli i zhurmave është brenda normave dhe nuk ndikon në shëndetin e punonjësve.
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ketë çlirime të aromave të ndryshme në ambientet përreth objektit e as në brendësi të tij.
- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës
- Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë nga aksidentet dhe për evitimin e rrezikut nga zjarri.
- Fenomene të tjera. Vibracioni, nxehtësia, radiacioni, ndriçimi verbues etj. nuk janë të pranishme.
- Trafiku rrugor. Gjatë këtij aktiviteti nuk do të ketë ndikime në aktivitetin rrugor.

Subjekti “ALION” Sh.p.k. ka mjetet e nevojshme teknike dhe financiare për të zhvilluar këtë aktivitet dhe kërkon të jetë e pajisur me të gjitha lejet përkatëse sipas legjislacionit shqipëtar.

Konkluzione

Në materialin e mësipërm shihet qarte se ka një ndikim minimal dhe pothuajse i papërfillshëm, por gjithsesi Subjekti “ALION” Sh.p.k. është e ndërgjegjshme se sado minimal ky ndikim duhet të mirë-menaxhohet dhe të bëhen perpjekje teknike për të bërë këtë ndikim me vlere zero.

Aktiviteti konsiderohet i përshtatshëm dhe i pranueshëm në zonën e zgjedhur nga investitori, pa krijuar probleme mjedisore për zonën përreth.

Subjekti "ALION" Sh.p.k. do ta ushtrojë veprimtarinë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe do të investojë për përmirësimin e mjedisit, punës dhe do të mirëpresë cdo sygjerim në të mirë të cilësisë së punës, si dhe aktiviteti ka bërë të mundur zbutjen e papunësisë në këtë zonë, duke punësuar një pjesë të mirë të banorëve të kësaj zone.

Aktiviteti jone nuk ka nevojë për procedurën e VNM paraprake ose të thelluar të Ligjit Nr 10 440 për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis, datë 7.7. 2011, pra nuk i nevojitet procedura e VNM, pasi është i pajisur me Leje Mjedisore dhe ka VNM të cilat do të dorezojë në QKB kur të aplikojë për Leje të Tipit B dhe në Përputhje me VKM nr. 419 date 25.06.2014 Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja , ky subjekt duhet të aplikojë për leje mjedisi të tipit B në AKM-Tirane.

Adresa e AKM-se, ku publiku mund të dergojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim ose në formë Elektronike:

Adresa: Rruga "Sami Frasheri", Nr.4, Tirane, - Tel/Fax 042 371 237 www.akm.gov.al

KONFORM TE TE GJITHA AKTEVE DHE PROCEDURAVE
LIGJORE NE FUQI I DREJTOHEM AKM-TIRANE PER NDJEKJEN E
PROCEDURES PER APLIKIMIN PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B:

ID 3.7 NXJERRJA E MINERALEVE, RËRËS DHE ARGJILËS NGA
MINIERAT ME SHFRYTËZIM NË QIELL TË HAPUR (KARRIERE E
SHFRYTEZIMIT TE GURIT GELQEROR PLLAKOR)

TEL: 0695141396

ADMINISTRATORI
HAXHI KREKU